



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUÇOVË

Nr. 805 Prot.

Kuçovë, më 05.03 2024

VENDIM

Nr. 14, datë 27.02.2024

**“PËR
MIRATIMIN PËR TRANSFERIM TË LISTËS SË PJESSHME TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE QË KËRKOHEN PËR TRANSFERIM NË PRONËSI
TË BASHKISË KUÇOVË, QARKU BERAT”.**

Këshilli Bashkiak Kuçovë në mbledhjen e tij të datës 27.022024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, referuar nenit 36, 37, 38 dhe 39 pika “1.b”, të ligjit 20/2020 “Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare Të Pronësisë Në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për Transferimin e Pronave të Paluajtshme Publike të Shtetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.500, datë 14.08.2001 “Për Inventarizimin E Pronave Të Paluajtshme Shtetërore Dhe Transferimin E Pronave Në Njësitë E Qeverisjes Vendore”, Udhëzimit nr.1, datë 15.02.2002 “Për Plotësimin E Formularit Për Inventarizimin Dhe Transferimin E Ambjenteve Administrative Në Pronësi Të Njësive Të Qeverisjes Vendore”, si dhe V.K.M- së Nr. 662 datë 08.10.2004 “Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kuçovë” i ndryshuar, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Miratimin për transferim të listës së pjesshme të pronave të paluajtshme shtetërore nga Njësia e Qeverisjes Qendrore drejt Njesisë te Qeverisjes Vendore, Bashkia Kuçovë, Qarku Berat, të pasurive me numër nr. 6/535, nr.6/455, nr. 6/167, nr. 6/145, nr. 6/156, nr. 12/343, nr. 12/344, nr. 7/105, nr.7/108, të ndodhura në ZK 2310, në pronësi të Bashkisë Kuçovë, sipas shtesës nr.1, bashkelidhur vendimit.

A: Lagjia nr.1, Blloku “ T. Skendo”, Kuçovë, Shqipëri. www.bashkiakucove.gov.al



2. Të shtohen pronat sipas listës së inventarit :

Numri rendor i pronës në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
578-582	Prona që do të përdoren në veprimtarit sportive dhe rekreative (sheshe, lulishte, parqe dhe shërbime publike)	Në pronësi
583-585	Prona që do të përdoren për realizimin e funksioneve ekonomike si dhe realizimin e funksioneve apo shërbimeve të tjera në funksion të bashkësisë	Në pronësi
586	Prona që do të përdoren për realizimin e funksioneve administrative	Në pronësi

3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit të Territorit Koordinimit – Zhvillimit Strategjik dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Berat.

Ky vendim u miratua me 20 vota pro, — vota kundër dhe — vota abstenim.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK
ALESKANDËR ZIU



FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHITËTËRORE

Bashkia Kuçovë

Identifikoi: **Ledja Lame (Specialiste)**
(emri, mbiemri pozicioni zyrtar)

Ervin Liko (Topograf)
(emri, mbiemri pozicioni zyrtar,)

Mirato: **Sokol Vasili (Drejtori)**
(Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: **Kreshnik Hajdari (Kryetar i Bashkisë Kuçovë)**
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula).

FUSHA E PËRDORIMIT: Shtesa 1 (Transferim në pronësi)Prona për shërbime të ndryshme

Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartës	Numri I Pasurisë	Lloji i Pronës	Emri i Pronës Adresa	Sip. Tot e Pronës (m2)	Sip e Nderesës (m2)	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjësi administrative	Institucioni / Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
578	2310 G-4	6/535	Truall	Llagja nr.2, Blloku "1 Maj"	116		Për zone rekreative dhe hapësira të gjelbërta	Bashkia Kuçove	Bashkia Kuçove	
579	2310 G-4	6/455	Truall	Llagja nr.2, Blloku "1 Maj"	121		Për zone rekreative dhe hapësira të gjelbërta	Bashkia Kuçove	Bashkia Kuçove	

580	2310 G-4	6/167	Truall	Llagja nr.2, Blloku "1 Maj"	249		Për zone rekreative dhe hapësira të gjelbërta	Bashkia Kuçove	Bashkia Kuçove	
581	2310 G-4	6/145	Truall	Llagja nr.2, Blloku "1 Maj"	8 476		Për zone rekreative dhe hapësira të gjelbërta	Bashkia Kuçove	Bashkia Kuçove	objekt mbi këtë pasuri nuk ekziston më
582	2310 G-4	6/156	Truall	Llagja nr.2, Blloku "1 Maj"	3 335		Për zone rekreative dhe hapësira të gjelbërta	Bashkia Kuçove	Bashkia Kuçove	objekt mbi këtë pasuri nuk ekziston më
583	2310 G-4	12/343	Truall	Llagja nr.1, Blloku "Tafil Skendo"	398		Për zhvillim ekonomik	Bashkia Kuçove	Bashkia Kuçove	
584	2310 G-4	12/344	Truall	Llagja nr.1, Blloku "Tafil Skendo"	96		Për zhvillim ekonomik	Bashkia Kuçove	Bashkia Kuçove	
585	2310 G-4	7/105	Truall	Llagja nr.1, Blloku "Tafil Skendo"	3344		Për zhvillim ekonomik	Bashkia Kuçove	Bashkia Kuçove	
586	2310 G-4	7/108	Truall	Llagja nr.1, Blloku "Tafil Skendo"	410		Për realizimin e funksioneve administrative	Bashkia Kuçove	Bashkia Kuçove	